



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

NH/388 prot.

Tiranë, më 8.5.2019

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi

DREJTORIVE NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE  
DEGËVE DOGANORE

Për publikim: **DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE**

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të Ligjit 102/2014 datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjit 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe VKM-së nr. 921 datë 29.12.2014 "Për personelin e Administratës Doganore", i ndryshuar, shpall konkurimin e hapur për pozicionin:

**Përgjegjës Sektori, Sektori i Koordinimit dhe Operativitetit në Terren, Drejtoria Antikontrabandës, pranë Departamentit Operativ Hetimor, Kategoria B, Kategoria e Pagës III-a/1, 1 (një) vend pune**

***Kandidatët që do të aplikojnë duhet të plotësojnë këto kritere:***

1. Të kenë shtetësi shqiptare
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar
3. Të gëzojnë shëndet të mirë për të kryer detyrat e tyre
4. Të mos kenë qenë të dënuar me vendim penal të formës së prerë
5. Të mos kenë qenë larguar më parë nga administrata shtetërore për thyerje të disiplinës ose shkelje të tjera serioze
6. Të zotërojnë diplomë të nivelit Master Shkencor në Shkencat Ekonomike, Juridike, Natyrore, ose të lidhura me Sigurinë dhe Hetimin
7. Eksperiencë pune të paktën 3 vjet në pozicion të nivelit ekzekutiv
8. Të ketë njohuri të paktën të një gjuhe të huaj.

Avantazhe:

Të ketë njohuri në fushën doganore.

***Përshkrim përgjithësues për pozicionin:***

- Siguron hartimin e një strategjie dhe planeve të një niveli sektorial dhe të detajuar, si dhe garanton se objektivat janë përmbushur brenda afateve kohore
- Përcaktimi i zonave të monitorimit ditor për specialistët e sektorit
- Mbledhje informative ditore dhe raportimi tek eprori
- Kontrolli në Sistem dhe Organizimi i Grupeve të Antikontrabandës në terren
- Koordinimi dhe dhënia e kontrolleve të Grupeve të Antikontrabandës në të gjithë territorin.
- Miratimi në dhenien e kontrollit dokumentar dhe fizik të Grupeve të Antikontrabandës nga specialistët e sektorit.
- Mbledhja e raporteve të Grupeve të Antikontrabandës për kontrollet.
- Akses në shpërndarjen e Sektorit të Antikontrabandës dhe bashkëpunim me përgjegjësit e tjerë të sektorit dhe miratimi nga eprori

***Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:***

1. Kërkesë për marrje pjesë në konkurim
2. Curriculum Vitae
3. Fotokopje e Diplomës dhe Lista e Notave të noterizuara (*Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit*)
4. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore /dëshmi penaliteti
5. Vërtetim nga Gjykata
6. Vërtetim nga Prokuroria
7. Vërtetim nga Tatim-Taksat
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore
9. Fotokopje të letërnjoftimit (ID)
10. Fotokopje të librezës së punës;
11. Letër reference dhënë nga eprori direkt i pozicionit të fundit të punës
12. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më sipër.

**Procedura e konkurimit** do të zhvillohet në dy faza.

Në fazën parakualifikuese kandidatët do të vlerësohen nga dokumentacioni i paraqitur nëse plotësohen kërkesat për konkurim. Aplikantët të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e përcaktuara skualifikohen.

Faza e dytë do të vijojë me kandidatët e kualifikuar për të marrë pjesë në intervistë. Rezultatet e intervistës bazohen në:

- a) Pervojën
- b) Kualifikimin
- c) Aftësitë

Kandidatët e përzgjedhur duhet të marrin mbi 70 pikë në intervistë.

Data e intervistës do të caktohet në një njoftim të dytë.

### **Rezultatet e konkurimit**

Lista me kandidatët fitues, do të shpallet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 18.05.2019, ora 16:00 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore/ Zyra e Sekretari/Protokollit.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Arlind Gjokuta**

